



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIME

Nr. 126/2012

Rrahim Bajrami

kundër

Gjykatës Themelore në Prishtinë

Çështja: Zvarritjet procedurale nga gjykata në vendosjen e lëndës
C.nr.911/2003, që ka të bëjë me vërtetimin e pronësisë

Palë përgjegjëse: Gjykata Themelore në Prishtinë
Z. Hamdi Ibrahim, kryetar

Baza ligjore: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135, paragrafi 3
Ligji për Avokatit e Popullit, neni 15 paragrafi 6

12 prill 2013
Prishtinë

Qëllimi i raportit

1. Ky raport është i bazuar në ankesën individuale të z. Rrahim Bajrami dhe mbështetet në faktet dhe provat të palës, si dhe nga shkresat e lëndës të cilat i posedon Avokati i Popullit, lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore dhe nxjerrjen e vendimit të kundërligjshëm në vendosjen e lëndës C. nr. 911/2003, që ka të bëjë me vërtetimin e pronësisë.
2. Rasti i z. Bajrami ka filluar të procedohet në gjykatë në vitin 2003 dhe deri më sot, 12 prill 2013, nuk është vendosur. Për 10 vjet pritje ankuesi, jo vetëm nuk arriti ta shohë drejtësinë gjyqësore, por gjykata me vendim atë e shpalli të vdekur, edhe pse ai është gjallë.
3. Ankuesi kishte blerë 50 ari tokë në fshatin Çagllavicë, në vitin 1970, nga pronari Urosh Steviq. Ai nuk e kishte kaluar në pronësi të tij tokën, ndonëse e kishte punuar atë pa problem deri në vitin 2000, pra 30 vjet me radhë. Problemet kanë filluar pas vitit 2000, kur kanë filluar të shiten tokat rreth pronës së tij dhe një ditë kjo pronë nga djali i Urosh Steviqit i është shitur dhe kaluar në pronësi dy blerësve të rinj.

Përmbledhja e fakteve

4. Faktet, dëshmitë dhe informatat me të cilat posedon Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), mund të përmbliidhen si në vijim:
5. Më 30 maj 2003, ankuesi ka parashtruar padi për vërtetimin e pronësisë në Gjykatën Komunale në Prishtinë.
6. Më 7 prill 2004, ankuesi ka parashtruar padi për pengim posedimin dhe propozimin për caktimin e masës së përkohshme, në Gjykatën Komunale në Prishtinë, lidhur me pronën e njëjtë.
7. Më 15. korrik 2004, Gjykata Komunale në Prishtinë me aktvendimin C. nr. 1634/2004 cakton masën e përkohshme, në lidhje me padinë për pengim posedimi.
8. Pas shtatë viteve dhe disa seancave shumë të rralla gjyqësore, pa sjellë ndonjë vendim gjyqësor përfundimtar, kontesti merr dimension tepër të koklavitur. Në fund të janarit të vitit 2009 është mbajtur një seancë pa prezencën e palës dhe pa e njoftuar paditësin z. Bajrami.
9. Më 24 mars 2009, Gjykata Komunale në Prishtinë me gjyqtarin e çështjes, z. Sami Gërdovci nxjerr aktvendimin për heqjen e masës së përkohshme të pronës (C.nr. 1634/2004), sipas kërkesës së përfaqësuesit të paditurve për abrogimin-heqjen e masës së përkohshme, me arsyetimin se pronari z.Rrahim Bajrami është i vdekur. Kjo masë ishte vënë në vitin 2004 dhe ende pa u zgjidhur kontesti, gjykata kishte lëshuar vendimin për abrogimin e masës së lëshuar, vetëm sipas kërkesës së përfaqësuesit të të paditurve, pa administruar dhe vërtetuar qoftë edhe një fakt të vetëm sipas Ligjit të Procedurës Jokontestimore, për shpalljen e vdekjes së personit kyq në këtë proces.

10. Më 28 janar 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë nxjerrë aktgjykimin C. nr. 911/2003, i cili ishte në favor të ankuesit, z. Bajrami.
11. Më 23 nëntor 2010, të paditurit ushtrojnë ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
12. Më 8 mars 2012, ankuesi paraqet ankesën e tij në IAP, lidhur me zvarritjen e procedurës për shqyrtimin e lëndës së tij, nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë.
13. Më 27 mars 2012, një këshilltare e IAP, e këshilloi ankuesin që t'i dërgojë një urgjencë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, për shpejtimin e procedurës në shqyrtimin e lëndës.
14. Më 2 prill 2012, ankuesi dërgoi urgjencë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, lidhur me shqyrtimin e lëndës së tij dhe kopjen e solli në IAP, më 24 maj 2012.
15. Më 16 gusht 2012, ankuesi u takua me Avokatin e Popullit në ditën e hapur me qytetarë, ku paraqiti ankesat e tij lidhur me zvarritjet gjyqësore.
16. Më 11 shtator 2012, Avokati i Popullit i dërgoi një letër Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, në të cilën kërkoi informata për veprimet e ndërmarra ose që planifikonte të ndërmerre që rasti i ankuesit të shqyrtohej brenda një afati të arsyeshëm bazuar në ligj.
17. Më 13 shtator 2012, Avokati i Popullit mori përgjigje nga kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë ku u njoftua se *"Kjo lëndë në gjykatë ka arritur me 23. 11. 2010, arsyeja e zvarritjes, ka lëndë me të vjetra se kjo lëndë dhe nuk është me prioritet. Andaj, kjo lëndë do të përfundohet sipas radhës"*.
18. Më 19 shtator 2012, ankuesi informon IAP se është i gatshëm të deklarohet para mediave lidhur me rastin e tij, se si është shpallur i vdekur nga Gjykata Komunale në Prishtinë.
19. Më 20 shtator 2012, ankuesi e njofton Institucionin e Avokatit të Popullit se është intervistuar nga KTV, në lidhje me çështjen e tij dhe për këtë falënderon IAP-në.
20. Më 19 nëntor 2012, ankuesi informon IAP, se gjykata e Qarkut ka marrë aktvendim për çështjen dhe më 5 nëntor 2012, e ka kthyer lëndën në Gjykatën Komunale në Prishtinë (tani Gjykata Themelore në Prishtinë), mirëpo palës nuk i është dërguar kopja e aktvendimit.
21. Më 10 janar 2013, ankuesi bisedoi më Avokatin e Popullit dhe e informoi lidhur me proceset gjyqësore që po zhvillohen lidhur me çështjen e pronësisë dhe çështjen se si është shpallur i vdekur nga gjykata.

Baza ligjore

22. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 46, paragrafi 1 përcakton se *"E drejta e pronës është e garantuar. Edhe paragrafi 3, i nenit 46 parasheh se askush nuk mund të privohet në mënyrë arbitrare nga prona."*
23. Neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës *"Çdo kujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike."*

24. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) është dokument ligjor i zbatueshëm drejtpërdrejtë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ka prioritet në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.
25. Paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ garanton që *“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm”*.
26. Ndërsa neni 13 i KEDNJ thotë: *“Çdo njeri, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me këtë Konventë, ka të drejtë për mjetet ligjore efektive për rivendosjen e së drejtës nga një autoritet kombëtare, pavarësisht se shkelja mund të jetë bërë nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”*.

I. Ligji për Procedurën Kontestimore (LPK), Nr. 03/L-006

27. Neni 1 i LPK përcakton *“rregullat procedurale në bazë të të cilave gjykata i shqyrton dhe zgjidhë kontestet nga marrëdhëniet juridiko-civile të personave fizikë dhe juridikë, po që se me ligj të posaçëm nuk është përcaktuar ndryshe”*.
28. Sipas nenit 10, paragrafi 1 të po këtij ligji *“Gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të të drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji.”*
29. Neni 176 i këtij ligji i njuh të drejtën që *“Kundër aktgjykimit të nxjerrë në shkallën e parë palët mund të bëjnë ankesë brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit [...] Ankimi i bërë brenda afatit të përcaktuar me ligj pengon që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë në pjesën e goditur me ankim. [...] Mbi ankimin kundër aktgjykimit vendosë gjykata e shkallës së dytë.”*
30. Po sipas këtij ligji, neni 185. *“Ankesa i paraqitet gjykatës e cila e ka dhënë aktgjykimin e shkallës së parë, në një numër të mjaftueshëm kopjesh për gjykatën dhe për palën kundërshtare.”* Duke precizuar në mënyrë shprehimore në nenin 187 që *“Një kopje të ankesës së paraqitur me kohë, të lejueshme dhe të plotë, gjykata e shkallës së parë ia dërgon palës kundërshtare, e cila mundet, brenda afatit prej shtatë ditësh, të paraqesë po në këtë gjykatë përgjigje në ankesë.”*
31. Paragrafi 1 i nenit 190 i këtij ligji përcakton edhe vazhdimin e mëtutjeshëm të shfrytëzimit të mjeteve ligjore efektive, duke kërkuar që *“Gjykata e Shkallës së dytë vendosë për ankesën në seancë të trupit gjykues ose në bazë të shqyrtimit të çështjes në seanca gjyqësore.”*

II: Ligji për Procedurën Jokontestimore (LPJ) nr. 03/L-007

32. Në lidhje me zhvillimin e një procedure gjyqësore jokontestimore, në rastet kur gjykata ballafaqohet me dyshimin se personat e përfshirë në një kontest gjyqësor nuk janë të gjallë, janë të vdekur apo janë të zhdukur, LPJ në nenin 59.1 kërkon shprehimisht që *“Personi që është shpallur i zhdukur me vendim gjyqësor, me*

kërkesën e çdo personi të interesuar, mund të shpallet i vdekur me vendim të gjykatës, kur kanë kaluar pa pasur informata tri vjet nga dita që është shpallur i zhdukur.”

33. Paragrafi i 2-të i po këtij neni, përcakton qartë edhe kriteret për vërtetimin dhe shpalljen e aktit të vdekjes së një personi të përfshirë në një proces gjyqësor, si në vijim:

- 1) *për jetën e të cilit gjatë pesë vjetëve të fundit nuk ka pasur kurrfarë informate, kurse nga lindja e tij kanë kaluar 65 vjet;*
- 2) *për jetën e të cilit gjatë pesë vjetëve të fundit nuk ka pasur kurrfarë informatash, kurse rrethanat në të cilat është zhdukur bëjnë të besohet se nuk është i gjallë;*
- 3) *që ka humbur gjatë luftës lidhu me veprimet luftarake dhe kjo vërtetohet nga organet kompetente ushtarake, për jetën e të cilit nuk ka pasur kurrfarë informatash për një vit nga dita që ka hyrë në fuçi marrëveshja e paqes, ose dy vjet nga mbarimi i veprimeve luftarake;*
- 4) *që ka humbur në një fatkeqësi komunikacioni, zjarri përmbytje, tërmet ose në ndonjë rrezik tjetër të drejtpërdrejtë për jetën, kurse për jetën e tij nuk ka pasur kurrfarë informatash për gjashtë muaj nga dita e heqjes së rrezikut.*

34. Sipas neni 61 të LPJ, propozimin për shpalljen e vdekjes së një personi mund ta paraqesë çdo person që për këtë ka interes juridik të drejtpërdrejtë, si dhe organi i kujdestarisë. Ndërsa neni 62 i po këtij ligji përcakton kriteret që duhet medocemos të përmbajë -propozimi për shpalljen e vdekjes së një personi:

- 1) *emrin e gjykatës të cilës i paraqitet,*
- 2) *emrin e mbiemrin e personit që duhet të shpallet i vdekur,*
- 3) *ditën e lindjes dhe vendbanimin ose vendqëndrimin e fundit,*
- 4) *rrethanat nëpërmjet të cilave bëhet e besueshme vdekja e tij,*
- 5) *provat me të cilat konstatohen këto rrethana,*
- 6) *emrin e mbiemrin e kujdestarit ose përfaqësuesit ligjor të tij, për rastet kur ka të tillë,*
- 7) *si dhe emrin dhe mbiemrin e personave që mund të jenë trashëgimtarë.*

35. Neni 64 i LPJ përcakton mënyrën e procedimit të gjykatës në rastin e vdekjes së personit: *“Në qoftë se është plotësuar ndonjë nga kushtet nga neni 59 i këtij ligji dhe se rezultatet e procedurës së tërësishme vënë në dukje në mënyrë të sigurt se personi i zhdukur nuk është gjallë, gjykata merr aktvendim me të cilin shpallet se ky person është i vdekur.”*

36. Ndërsa Neni 65, pika 1 të LPJ, shprehimisht përcakton elementet e domosdoshme që duhet të përmbajë aktvendimi për shpalljen e faktit të vdekjes së një personi të caktuar: *“Në aktvendimin me të cilin shpallet vdekja e personit të zhdukur do të tregohet emri e mbiemri i prindërve të tij, dita, muaji, viti dhe vendi i lindjes, pastaj të konstatohet dita muaji dhe viti e brenda mundësive edhe ora që konsiderohet si kohë e vdekjes së personit të zhdukur [...]”*

37. Neni 66 i LPJ përcakton mënyrën e procedimit të vendimit të formës së prerë të gjykatës: *“Vendimi i formës së prerë mbi shpalljen e personit të zhdukur do t’i dërgohet shërbimit të gjendjes civile për regjistrimin në librin amzë, gjykatës kompetente për zhvillimin e procedurës trashëgimore, organit të kujdestarisë dhe organit që mban librin e palujtshmërive, po qe se personi që është shpallur i vdekur ka pasuri të paluajtshme.”*
38. Neni 67.1 i LPJ përcakton procedurën e prishjes së vendimit të gjykatës nga vetë gjykata në rast të paraqitjes së personit për të cilin është marrë vendimi: *“Personi që është shpallur i vdekur i paraqitet personalisht Gjykatës që ka dhënë vendimin, gjykata pasi të konstatojë identitetin e tij, pa procedurë të mëtejme, vendimin e këtillë e prish me anë të aktvendimit të posaçëm [...]”*
39. Neni 68. 1 të LPJ, përcakton mënyrën e veprimit të gjykatës në rast të pranimit të informatës se personi i shpallur i vdekur, është i gjallë: *“Në qoftë se pas dhënies së vendimit për shpalljen e vdekjes së personit të zhdukur gjykata e çështjes në çfarëdo mënyre informohet se ai është i gjallë, sipas detyrës zyrtare e zhvillon procedurën në të cilën e prish vendimin e tillë [...]”*
40. Neni 70, paragrafi 1 i LPJ, në rastet e fillimit të procedurës për anulimin ose ndryshimin e vendimit për shpalljen e vdekjes së personit të zhdukur, kërkon shprehimisht që gjykata të *“[...] njofton organin e kujdestarisë, nëse nuk e ka iniciuar procedurën në fjalë, dhe gjykatën trashëgimore para së cilës është duke u zhvilluar procedura, për ndarjen e pasurisë së këtij personi [...]”*
41. Ndërsa neni 72 i LPJ, parasheh që *“Aktvendimi i formës së prerë mbi heqjen nga fuqia ose ndryshimin e vendimit për shpalljen e vdekjes së personit të zhdukur i dërgohet shërbimit kompetent për mbajtjen e librave përkatëse, gjykatës trashëgimore dhe Organit të kujdestarisë.”*

Analiza ligjore

42. Parashtruesi ankohet se dështimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë (ish-Gjykata Komunale në Prishtinë), për të vendosur lidhur me rastin e tij, prej majit 2003 e deri në vitin 2010, së bashku me dështimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, për të vendosur prej periudhës 28 janar 2010 deri në nëntor 2012, kishin bërë shkelje të së drejtës së tij, për proces të drejtë, brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ, i cili garanton që: *“Në përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve civile çdo kush ka të drejtë për proces të hapur dhe të drejtë brenda një afati të arsyeshëm[...]”*.
43. I njëjti parim është bartur edhe në nenin 10.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i përcakton se: *“Gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të të drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji”*
44. Që në fillim, Avokati i Popullit vëren se çështjet pronësore konsiderohen të jenë të drejta civile, për qëllime të nenit 6 të Konventës, i cili për këtë arsye është i aplikueshëm në procedurat e rastit në fjalë.

45. Avokati i Popullit përkujton që, e drejta precedente e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka vërtetuar që në rastet ku përfshihet përcaktimi i të drejtës civile, zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurës gjyqësore (shih aktgjykimin *Girolomi kundër Italisë*, më 19 shkurt 1991 dhe aktgjykimin *Boddaert kundër Belgjikës*, më 12 tetor 1995). Për rastin në fjalë, procedura gjyqësore ishte filluar në Gjykatën Komunale në Prishtinë, më 30 maj 2003 dhe ende vazhdon në vitin 2013.
46. Po ashtu, Avokati i Popullit përkujton se neni 6 (1) i KEDNJ nuk parashkruan ndonjë afat absolut për përcaktimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës. Ai përcaktim varet nga rrethanat e veçanta të rastit, veçanërisht nga ndërlikueshmëria e rastit, sjellja e palëve dhe autoriteteve të përfshira, si dhe prej asaj çfarë është në interes për ankuesin.
47. Sipas GJEDNJ, është e domosdoshme të bëhet një vlerësim i përgjithshëm i procedurave me qëllim të përcaktimit të arsyes për zgjatje të procedurës. Kjo do të thotë që, vonesat e caktuara lidhur me një pjesë të procedurave mund të mos përbëjnë shkelje nëse zgjatja e tërësishme e procedurës nuk ka qenë e tepruar. Nga provat dhe dëshmitë e prezantuara, Avokati i Popullit nuk gjen arsye për zvarritje të procedurës.
48. Avokati i Popullit vëren se për rastin në fjalë, periudha përkatëse për t'u shqyrtuar fillon prej 30 majit 2003, data kur ankuesi paraqiti ankesën-padinë e tij të parë në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Pasi ende nuk është marrë vendim përfundimtar lidhur me rastin dhe lënda tani gjendet për shqyrtim në Gjykatën Themelore në Prishtinë, data e fundit e hetimit të këtij rasti në shqyrtim llogaritet data e publikimit të këtij raporti. Prandaj, Avokati i Popullit konsideron se procedurat kanë zgjatur afër 10 (dhjetë) vite.
49. Lidhur me sjelljen e autoriteteve, Avokati i Popullit vëren se, që nga muaji maj i vitit 2003, Gjykata Komunale në Prishtinë, kishte mbajtur disa seanca të rralla pa sukses, meqenëse lidhur me rastin ishte paraqitur edhe padia për pengim posedim (shih paragrafin 2 dhe 3). Dështimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë është dëshmuar me marrjen e aktvendimit më 24. 03. 2009, për heqjen e masës së përkohshme, e cila ishte vendosur më 15.7.2004, me pretendimet se paditësi z. Bajrami kishte vdekur, andaj procedura është ndërprerë.
50. Në këtë rast, Gjykata Komunale në Prishtinë kishte vepruar vetëm sipas kërkesës së përfaqësuesit të palës së kundërt, pa marrë në konsideratë veprimet procedurale dhe pa vërtetuar asnjë fakt dhe rrethanë se si ka vdekur personi, bazuar në ligjin përkatës. Pra, ka qenë dështim total i gjyqtarit dhe kjo pasqyron mungesë të kujdesit dhe përgjegjësisë nga ana e gjykatës.
51. Nga analiza e Ligjit për Procedurën Jokontestimore, vërehet se ligji shprehimisht përcakton kushtet e shpalljes së vdekjes së një personi, të cilat gjykata kompetente fare nuk e kishte marrë në konsiderim dhe pa kërkuar asnjë fakt ose provë të vetme. Përveç se vërehet se ligji ka përcaktuar kushtet bazike për shpalljen e vdekjes së një personi, po ashtu vërehet se nuk ka asnjë normë në këtë ligj i cili lejon, autorizon apo bartë të drejtën tek ndonjë subjekt juridik i caktuar, për nxjerrje të normave ligjore për caktimin e kushteve të veçanta për shpalljen e vdekjes së një personi.

52. Pala po ashtu ankohet edhe për vonesën e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, për t'ia dorëzuar aktvendimin me shkrim të marrë më 5 nëntor 2012, të cilin pala nuk e ka pranuar ende, ndërsa lënda është kthyer në rigjykim në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Kjo i ka pamundësuar shfrytëzimin e mjeteve efektive ligjore ndaj vendimeve gjyqësore dhe paraqet shkelje të drejtës së tij për ankimim, të garantuar me nenin 176 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

53. Lidhur me fushën e zbatueshmërisë së nenit 13 të KEDNJ, Avokati i Popullit përkujton se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në disa raste shprehimisht e ka theksuar se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë, përbëjnë një kërcënim serioz për sundimin e ligjit të vendit. Kufizimet e theksuara në nenin 13 të KEDNJ, gjykata i komenton kështu:

“Për sa i përket dështimit të supozuar për të siguruar seancë brenda një afati të arsyeshëm, nuk mund të shquhet asnjë kualifikim i tillë në fushën e nenit 13. Në të kundërtën, vendi i nenit 13 në skemën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të paraparë me konventë, më shumë favorizon mbajtjen në minimum të kufizimeve të nënkuptuara me nenin 13.” (aktgjykimi në rastin Kudla kundër Polonisë, 26 tetor 2000).

54. Neni 13 i KEDNJ, duke theksuar në mënyrë të veçantë dhe shprehimisht obligimin e shtetit që, që në radhë të parë të mbrojë të drejtat e njeriut përmes sistemit të tij ligjor, ofron garanci shtesë për një individ që ai apo ajo gëzon këto të drejta në mënyrë efektive. Kërkesat e nenit 13 përkrahin dhe përforcojnë ato të nenit 6 të KEDNJ (Kudla kundër Polonisë, 26 tetor 2000). Pra, neni 13 garanton një mjet efektiv ankimi pranë një autoriteti vendor, për një shkelje të pohuar të kërkesave sipas kuptimit të nenit 6, për ta shqyrtuar një rast brenda një kohe të arsyeshme. Meqenëse rasti i z.Bajrami ka të bëjë me ankesën lidhur me kohëzgjatjen e procedurës, neni 13 i KEDNJ është i zbatueshëm.

55. Avokati i Popullit konstaton që ka pasur shkelje të së drejtës për proces të rregullt gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me aktet ligjore të lartpërmendura, dhe se ka pasur shkelje të së drejtës për mjete efektive juridike ndaj vendimeve gjyqësore (mosdorëzimi i vendimit gjyqësor) dhe të shkeljes të së drejtës për të qenë palë në shqyrtimin gjyqësor (për shkak të shpalljes së personit të vdekur nga gjykata).

56. Avokati i Popullit vëren se asnjë mënyrë apo rrugë e veçantë ligjore nuk ka ekzistuar dhe nuk i është vënë në dispozicion ankuesit, përmes së cilës ai do të kishte mundur të ankohet për zvarritje të procedurës, me parashikimin apo shpresën për ta arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit të padrejtësisë apo kompensimit për padrejtësinë e përjetuar. Kjo mënyrë e veprimit të gjykatës dëshmon për mohimin e drejtësisë dhe ligjshmërisë nga vetë gjykata.

57. Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, “[...] ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore”, dhe me nenin 15, paragrafi 6 të Ligjit Nr.03/L-195 për Avokatin e Popullit, sipas të cilit “Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç në rastet të zvarritjeve të paarsyeshme apo keqpërdorimit të dukshëm të pushtetit.”,

bazuar në analizën ligjore të mësipërme, në cilësinë e rekomanduesit për Gjykatën Themelore në Prishtinë, duke ju referuar argumenteve të lartpërmendura, me qëllim të përmirësimit të punës në sistemin gjyqësor të Kosovës,

Rekomandon:


Gjykatën Themelore në Prishtinë

1. Marrjen e masave të menjëhershme për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës gjyqësore të ankuesit Rrahim Bajrami, pa vonesë të mëtutjeshme.
2. Të anulohet vendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, për shpalljen të vdekur ankuesin Rrahim Bajrami.
3. Të merren masa ndaj veprimeve/keqpërdorimeve eventuale të gjyqtarëve përkatës, për shpalljen të vdekur ankuesin Rrahim Bajrami, si dhe të zvarritjen e paarsyeshme të procedurës gjyqësore, në rastin e Rrahim Bajramit.
4. Të garantojë shqyrtimin e rasteve dhe dorëzimin e aktgjykimeve për të gjitha palët brenda një afati të arsyeshëm kohor, në pajtim me nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së.

Në pajtim me nenin 132 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 26 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 03/L-195, Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmarrë Gjykata Themelore në Prishtinë, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartpërmendura.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunim, Ju lutem që përgjigjen tuaj, në lidhje me këtë çështje, ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm ligjor, por jo më shumë se tridhjetë (30) ditë.

Me nderime,


Samir Kurteshi
Avokat i Popullit

Kopje: Këshilli Gjyqësor i Kosovës, kryesues z. Enver Peci.

Zyra e Prokurorit Disiplinor të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, drejtor z. Zef Prendrecaj.